

## NË RASTIN E SHQIPËRISË

### Projekti Greenback në Shqipëri

- projekti Greenback 2.0 synon promovimin e kanaleve kosto-eficiente për dërgimin e remitancave;
- projekti adreson nevojat specifike financiare dhe të pagesave të marrësve të remitancave në Shqipëri;
- procesi synon përfshirjen e autoriteteve lokale dhe ofruesve të shërbimeve të transfertave monetare dhe vendosjen e marrëdhënieve të afërt mes individëve emigrantë që dërgojnë të ardhura dhe institucioneve financiare.

### Përfshirja financiare

- Vetëm 40% e popullsisë (15+) disponon llogari bankare (larg mesatares së Eurozonës prej 95%);
- 42% e popullatës (15+) zotëron karta debiti.

### Infrastruktura bankare, T1-2019

- 14 banka dhe 430 degë,
- 12 banka ofrojnë Home Banking,
- 700 ATM dhe 9,290 POS,
- 7 MTO, të cilat janë aktive në tregun e transfertave.

Tabelë 2: Komisionet sipas korridoreve kryesore

Vendet	Kosto (në %)		
	Mesatare	Më e lira	Më e shtrenjta
Italia	7.96	1.79	15.00
Greqi	-	-	-
UK	9.58	5.41	12.74
Gjermania	9.06	4.88	19.82

Burimi: Banka Botërore, <https://remittanceprices.worldbank.org/en>

**INOVACIONI DHE PËRFSHIRJA FINANCIARE NDIHMON  
NË REDUKTIMIN E KOSTOVE TË TRANSFERTAVE.**

## FJALORTH

**Remitanca:** Botimi 6 i Manualit të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve (FMN, 2009), përcakton remitancat si shuma e dy komponentëve: të ardhura nga puna dhe transferta personale.

**Diaspora, Emigrantë:** Një komunitet njerëzish që jetojnë jashtë vendit të tyre të origjinës dhe mbajnë lidhje me atdheun ose të afërmit e tyre. Komunitetet e diasporës zakonisht janë të lidhura emocionalisht dhe financiarisht me të afërmit në vendin e tyre të origjinës.

**Operator i transferimit të parave (MTO):** Institucion i parasë elektronike që ofron shërbimin e pagesave dhe transferimit të parave, pa i kërkuar dërguesit hapjen e një llogarie bankare.

**Home banking:** Shërbime bankare, të cilat ofrojnë aksesimin e llogarisë me mjete të ndryshme komunikimi në distancë, si internet, telefon etj.

## REFERENCA

Banka e Shqipërisë

INSTAT

Banka Botërore: Baseline survey on remittance beneficiaries' financial behaviors in East Europe and Central Asia, 2016


Banka Botërore: The Global Findex Database, 2017

Banka Botërore, <https://remittanceprices.worldbank.org/en>

## NJË VËSHTRIM MBI

# REMITANCAT

## DIASPORA NË BOTË



**Banka e Shqipërisë, 2019**


## ROLI I REMITANCAVE\*

Remitancat përbëjnë fluksin më të madh hyrës në ekonominë shqiptare, duke lënë pas investimet e huaja direkte dhe eksportet. Ato kanë qenë fluksi financiar më i qëndrueshëm dhe më i sigurt në ekonominë shqiptare, në vite.

Remitancat janë burim të ardhurash për rreth 26% të familjeve shqiptare. Ato kontribuojnë pozitivisht në arsimim, shëndetësi, investime, si dhe në uljen e varfërisë.

Remitancat nxisin përfshirjen financiare të popullatës, e cila ndikon në rritjen e mirëqenies, reduktimin e pabarazisë në vend dhe fuqizon rritjen ekonomike.

### Dita ndërkombëtare e remitancave



Tabelë 1. Remitancat (milionë euro)

Remitancat (milionë euro)	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Flukset hyrëse të remitancave	964.81	1,073.25	1,165.11	1,179.84	1,157.95	1,236.96
nga të cilat:						
Të ardhura nga puna	189.23	250.05	271.20	279.75	285.49	309.47
Transferata personale	775.58	823.20	893.91	900.09	872.47	927.49
Flukset dalëse të remitancave	143.45	134.77	138.27	132.72	94.51	97.51
nga të cilat:						
Të ardhura nga puna	35.09	30.44	25.89	19.40	22.52	24.54
Transferata personale	108.36	104.32	112.38	113.32	71.99	72.97

Burimi: Banka e Shqipërisë, 2018.

## STATISTIKA KYÇE

### Emigracioni dhe fluksi<sup>1</sup>

- Numri i emigrantëve rreth 1.19 milionë individë;
  - në Evropë, 90% e emigrantëve;
- Emigrantët e përhershëm përbëjnë 80% të totalit (shifër kjo mbi mesataren rajonale<sup>2</sup>);
- remitancat 1,237 milionë euro;
  - nga vendet evropiane 1,099 milionë euro;
- remitanca ndaj totalit të PBB-së, 9%.

### Kanalet e dërgesave

- 57% dërgohen përmes MTO-ve (dukshëm mbi mesataren rajonale, 40%);
- 39% dërgohen fizikisht (mesatarja rajonale 23%);
- një pjesë mjaft e vogël vjen përmes sistemit bankar, 4% (mesatarja e rajonit 7%).

### Tipologjia e dërguesve dhe marrësve

- 52% e dërguesve i përkasin moshave 30-44 vjeç,
- 71% e dërguesve janë meshkuj dhe 60% i përkasin emigracionit të përhershëm,
- dërgesat nga jashtë përbëjnë 90% të të ardhurave familjare të marrësve,
- rreth 1/3 e familjeve i përdorin për shpenzime bazë (ushqime dhe barna),
- rreth 41% e marrësve i kursejnë një pjesë të dërgesave,
- 86% e familjeve marrëse i sigurojnë dërgesat nga 1 person i vetëm në emigracion,
- 32% e këtyre familjeve marrin dërgesa prej mbi 10 vjetësh.

**40% e popullsisë mbi 15 vjeç të vendit disponon llogari bankare.**

<sup>1</sup> Burimi: INSTAT 2015, OKB 2018, Banka e Shqipërisë 2018.

<sup>2</sup> Vendet e përfshira në rajon: Serbi, Shqipëri, Kosovë, Bosnje Hercegovinë, Kirgistan, Taxhikistan.

## ANGAZHIMI GLOBAL

- Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi unanimisht rezolutën A/RES/71/237 për shpalljen e datës 16 qershor si Dita Ndërkombëtare e Remitancave.
- G20 ka vendosur si objektiv uljen e kostonë së transferimit të remitancave nën vlerën 3% deri në vitin 2030 dhe eliminimin e korridoreve me kosto mbi 5%.
- Kostoja aktuale e monitoruar në fillim të vitit 2019 rezultoi 6.9%, krahasuar me 7.5% në vitin 2017.
- Në Shqipëri, kostoja e dërgesave rezulton 8.9%.
- Banka Ndërkombëtare për Rregullime (BIS) ka shpallur "Parimet e përgjithshme" për tregje eficiente të remitancave në janar 2007.
- Këto parime janë adoptuar edhe nga institucione të tjera ndërkombëtare sikurse Forumi i Stabilitetit Financiar, G8 dhe G20.
- Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare ka përpiluar një udhëzues në lidhje me rregullimin e aktiviteteve të mikrofinancimit në vitin 2011 dhe udhëzuesin e "Parimeve bazë për mbikëqyrje bankare efektive për institucionet që lidhen me përfshirjen financiare".
- Projekti Greenback 2.0 i Bankës Botërore (tetor 2014) për rritjen e eficiencës së tregjeve të remitancave përmes ndërgjegjësimit dhe edukimit financiar u zbatua në Itali, Francë, Mbretërinë e Bashkuar, Malajzi, Indonezi dhe Haiti.

